



HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A
BORDI I DREJTORËVE

Nr. I/156

Datë: 30.10.2024

Bazuar në Nenin 12 të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Nenin 19 të Rregullores Nr. 02/2013 (të ish-MF) për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare në Organizatat Buxhetore, Nenin 6 të Rregullores për Regjistrimin/Inventarizimin e Mjeteve Themelore, Stoqueve dhe Parasë së Gatshme në HK-Trainkos Sh.A 20 Nr. I/74, të datës 30.04.2024, mbështetur në Ligjin Nr. 03/L -087 për Ndërmarrjet Publike, Nenin 162 të Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare, Nenin 15.3 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Nenin 15.2.3 të Statutit të HK-Trainkos Sh.A Nr. I/02, të datës 19.01.2024, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A në Mbledhjen Nr. 13, të mbajtur më 30.10.2024 njëzëri mori këtë:

VENDIM

Për regjistrimin/inventarizimin e pasurisë dhe të detyrimeve sipas gjendjes më datë 31.12.2024.

- I. Me këtë vendim udhëzohen formimet e komisioneve që të bëjnë regjistrimin e pasurive, inventarizimin e aseteve dhe detyrimeve të HK-Trainkos Sh.A si në vazhdim:
 - a) Për regjistrimin/inventarizimin e investimeve jo-materiale, pasurive të paluajtshme, objekteve, makinerive dhe pajisjeve si dhe furnizimeve me pjesë rezervë, të themelohet Komisioni prej tre anëtarëve, dhe
 - b) Për regjistrimin e qarkullimeve financiare, letrave me vlerë, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme, delikuentave (Interesi aktual) aktive dhe pasive dhe të pasurive tjera, të themelohet komisioni prej tre anëtarë (ose më shumë).
- II. Regjistri i pasurisë dhe i detyrimeve të kryhet për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024 sipas gjendjes së datës 31.12.2024.
- III. Raporti për regjistrimin e kryer i dorëzohet Bordit të Drejtorëve, Kryeshefit Ekzekutiv jo më vonë se data 28.01.2025 me qëllim të aprovimit dhe vendosjes rreth gjetjeve/devijimeve të konstatuara.
- IV. Gjatë dorëzimit të Raportit atij duhet t'i bashkëngjiten:
 - a) Listat e regjistrimit,
 - b) Deklaratat e punonjësve përgjegjës për gjetjet/devijimet e konstatuara,
 - c) Vërejtjet dhe konstatimet e komisionit etj.

- V. Raporti për regjistrimin e kryer dhe vendimi për zbatimin e rekomandimeve të Bordit të Drejtorëve (autoriteti përkatës) do t'i dorëzohet personit që drejton librat më së voni deri më datë 15.02.2025, me qëllim të optimalizimit të kohës për plotësimin e rekomandimeve dhe përgatitjen e raportit financiar vjetor, respektivisht 30 ditë para datës së dorëzimit të pasqyrave financiare.
- VI. Vendim për themelimin e komisioneve dhe emërimin e anëtarëve të komisioneve për kryerjen e regjistrimit dhe të inventarizimit të aseteve dhe detyrimeve e sjell Kryeshefi Ekzekutiv i HK-Trainkos Sh.A.
- VII. Vendimi hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Për Bordin e Drejtorëve

Jetmir NUKA – Kryesues



Iu dërgohet:

- Kryeshefit Ekzekutiv
- Zyrtarit Kryesor Financiar dhe të Thesarit
- Arkivit